



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: ishmm@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. nr.

4400

Prishtinë, Dt:

19.09.2023

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti i

Shkencave Matematike Natyrore

Lëndët

Gjeografia ekonomike, Pedogjeografia, Gjeografia nacionale I, Gjeoeconomia, Metodat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike, Gjeostatistika, Gjeografia e turizmit, Gjeografia nacionale II, Gjeografia e transportit.

Kandidatët e paraqitur

Albert Berila

Avni Krasniqi

Rinor Qollopeku

Amir Zullifi

Komisioni Vlerësues

1. Kryetar

Prof. Dr. Florim Isufi

2. Anëtar

Prof. Assoc. Dr. Shpejtim Bulliqi

3. Anëtar

Prof. Assoc. Dr. Mimoza Dushi



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1	Albert Berila	MSc.				9.22	9.54		12.03.1997	1	Jo	Po
2	Avni Krasniqi	Dr.				7.89	8.50		17.10.1981	0	Jo	Jo
3	Rinor Qollopeku	MSc.				9.38	9.21		18.10.1989	0	Jo	Jo
4	Amir Zullfi	MSc.				8.08	8.06		16.11.1990	0	Jo	Jo

Në bazë të Rregullores për angazhimin të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.2021, komisioni vlerësues se:



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: ishmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë, Dt: _____

1. Me analizën e dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se kandidati MSc. Albert Berila i plotëson të gjitha kushtet e parapara me statutin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.2021, që të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: **Gjeografia ekonomike, Pedogjeografia, Gjeografia nacionale I, Gjeoekonomia, Metodat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike, Gjeostatistika, Gjeografia e turizmit, Gjeografia nacionale II, Gjeografia e transportit** për vitin akademik 2023/2024. Kandidati MSc. Albert Berila në vitin akademik 2022/2023 ka qenë i angazhuar në lëndët e lartcekura dhe ka treguar profesionalizëm të lartë akademik. Kandidati MSc. Albert Berila paraqet potencial profesional dhe shkencor në trend me zhvillimet metodologjike hulumtuese bashkëkohore. Kjo është konstatuar me numrin e madh të punimeve shkencore të cituar gjithandej. Bazuar në dëshmitë e ofruara nga kandidati dhe të vërtetura në platformat indeksuese, puna shkencore e kandidati deri më tani është cituar si: *Scopus*: 32 citime, *Google Scholar*: 41 citime, *Web of Science*: 17 citime, që aktualisht është kërkesë dhe politike zhvillimore e UP “Hasan Prishtina”. Nga analiza e punimeve të tij vërehet aplikim i metodologjisë bashkëkohore hulumtuese shkencore, analitike me nuanca të gjeografisë inxhinierike. Kandidati, deri me tani, ka të publikuara si autor i parë dhe/apo autor korrespondent gjithsej **8 punime** shkencore, të indeksuara në platformat më kredibile shkencore ndërkombëtare “*Scopus*” dhe “*Web of Science*”, **4 punime dhe pjesëmarrje** në konferencat ndërkombëtare, bashkëpunëtor i **1 projekti**, mirënjohje “*student i dalluar*” në FSHMN, 2 bursa universitare të UP-së dhe 2 bursa të “*Student i elitës*” në Universitetet publike të Kosovës nga MASHT. MSc. Albert Berila ka aftësi të larta bashkëpunimi me kolegë, profesorë dhe studentë. Gjatë vitit akademik 2022/2023, sa ishte i angazhuar si bashkëpunëtor në Departamentin e Gjeografisë, pranë FSHMN-së, ka treguar rezultate të larta në ushtrime si dhe në përcjelljen e teknikës hulumtuese bashkëkohore tek studentët. Kandidati MSc. Albert Berila



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr: Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: ishmm@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë, Dr: _____

është njohës i shkëlqyer i shumë programeve kompjuterike profesionale, nga ato të GIS-it e deri tek programet më të avancuara në shkencën e gjeografisë, si Remote Sensingut dhe gjeostatistikave. MSc. Albert Berila ka përfunduar edhe shumë trajnime, ndër të cilat edhe dy nivelet e organizuara nga Qendra për përsosmëri në mësimdhënie, UP “Hasan Prishtina”, “*Mësimdhënia në arsimin e lartë*”, dhe “*Planifikimi dhe implementimi i mësimdhënies në arsimin e lartë*”. Kandidati MSc. Albert Berila është edhe njohës i mirë i gjuhës angleze.

Bazuar në të gjitha ato që u cekën më lartë dhe përgatitjen profesionale, i propozohet Këshillit të Fakultetit që kandidatin MSc. Albert Berila ta zgjedh në pozitën bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në pozitën nr. 12 në lëndët: **Gjeografia ekonomike, Pedogjeografia, Gjeografia nacionale I, Gjeoekonomia, Metodat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike, Gjeostatistika, Gjeografia e turizmit, Gjeografia nacionale II, Gjeografia e transportit..**

2. Nga dokumentacioni i ofruar u konstatua se kandidati Dr. Avni Krasniqi përkundër përgatitjes së mjaftueshëm profesionale, nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 7, pika 3.3 të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.202. Bazuar në këtë, kandidatin Dr. Avni Krasniqi nuk propozon që të zgjedhët bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në pozitën nr. 12 të këtij konkursi.
3. Nga dokumentacioni i ofruar u konstatua se kandidati MSc. Rinor Qollopeku përkundër përgatitjes së mjaftueshëm profesionale nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 7, pika 3.3 të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.202. Bazuar në këtë, kandidatin MSc. Rinor Qollopeku nuk propozon që të zgjedhët bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në pozitën nr. 12 të këtij konkursi.
4. Nga dokumentacioni i ofruar u konstatua se kandidati MSc. Amir Zullufi përkundër përgatitjes së mjaftueshëm profesionale nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 7, pika 3.3 të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fsbmm@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. nr.

Prishtinë, Dt:

të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.202. Bazuar në këtë, kandidatin MSc. Amir Zullufi nuk propozon që të zgjedhët bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në pozitën nr. 12 të këtij konkursi.

Dt.18.09.2023, Prishtinë

Komisioni:

1. Prof. Dr. Florim Isufi, kryetar
2. Prof. Assoc. Dr. Shpejtim Bulliqi, anëtar
3. Prof. Assoc. Dr. Mimoza Dushi, anëtar

